



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1170 prot.

Tiranë, më 30.04.2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1105/5, DATË 25.10.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. AGIM HARIZI, LIDHUR ME VEPRIMTARINË E PROKURORIT S.K. DHE PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË ANKESËS LIDHUR ME VEPRIMTARINË E PROKURORIT SH.K."**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e bashkuara të paraqitura të z. Agim Harizi me nr. 546 prot., datë 24.03.2020 dhe nr. 599 prot., datë 15.04.2020, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve S.K. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe ish magjistratit SH.K. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar, dhe me vendimin nr. 1105/5 prot., datë 25.10.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Agim Harizi, lidhur me veprimtarinë e prokurorit S.K. dhe përfundimin e verifikimit pa një vendim përfundimtar të ankesës lidhur me veprimtarinë e prokurorit SH.K.", bazuar në nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Rruga "Myslym Keta", Pallati nr.83, Shkalla 1, Apartamenti 1, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

